



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E LARTË
Këshilli i Gjykatës

Nr. 1 Prot.

Tiranë, më 21/01/2021

V E N D I M

Nr. 1, datë 21.01.2021

**PËR
MIRATIMIN E STRUKTURËS, ORGANIKËS, PËRSHKRIMIN E PUNËS DHE
KLASIFIKIMIT TË VENDEVE TË PUNËS TË PUNONJËSVE TË GJYKATËS SË
LARTË**

Në mbështetje të shkronjës “c” të nenit 38 të ligjit nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”; të Vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 643, datë 23.12.2020 “Për miratimin e rregullave standarte për organigramën, përshkrimin e detyrave dhe përgjegjësi të kategorive të punonjësve të Gjykatës së Lartë”, Këshilli i Gjykatës së Lartë, në mbledhjen e datës 21.01.2021,

V E N D O S I :

1. Miratimin e strukturës, organikës dhe klasifikimit të vendeve të punës të punonjësve të Gjykatës së Lartë, sipas Lidhjes nr. 1 bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij vendimi.
2. Miratimin e përshkrimit të punës të nëpunësve civilë gjyqësor Gjykatës së Lartë, sipas Lidhjes nr. 2 bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Kancelari në detyrë i Gjykatës së Lartë të paraqesë për miratim në Këshillin e Gjykatës vendimet e reja individuale të punonjësve të Gjykatës së Lartë, të cilët për efekt të këtij Vendimi, sistemohen apo transferohen në pozicione të reja pune, siç përcaktohen në Lidhjen nr. 1.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI
SOKOL SADUSHI**

**ANËTAR
ILIR PANDA**

**ANËTAR
KELMENT GRECA**

